



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr. 3210

Prishtinë, Dt. 10/09/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES  
MASTER

FAKULTETI	ShMN
Departamenti/ Programi	Biologji/Biologji
Projektpropozimi	Veçoritë faunistike të disa grupeve të merimangorëve (Arachnida: Opiliones, Araneae) në Ballkanin Perëndimor Faunistic characteristics of some groups of arachnids (Arachnida: Opiliones, Araneae) in Western Balkan
Kandidati	Krenare Ibrahim
Mentori	Prof. Dr. Linda Grapci Kotori
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.02.2025 Vendimi nr.: 683
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Tema e masterit, "Veçoritë faunistike të disa grupeve të merimangorëve (Arachnida: Opiliones, Araneae) në Ballkanin Perëndimor" e kandidatës Blertina Islami është punuar në Departamentin e Biologjisë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, përkatësisht laboratorin e Zoologjisë të Universitetit të Prishtinës.</p> <p>Dorëshkrimi është i shkruar në 47 faqe me radhor normal ku janë të përfshirë këta kapituj: Hyrja, Materiali dhe metodat e punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, dhe Literatura. Gjithashtu në punim janë të prezantuar: 23 tabela dhe 14 figura. Kandidati gjatë shkruarjes së dorëshkrimit ka shfrytëzuar literaturë të begatshme përkatësisht 30 njësi bibliografike dhe burime tjera nga interneti.</p>

Puna është zhvilluar sipas dinamikës së paraparë me planin dhe programin e punës dhe është realizuar në tri faza:

1. Hulumtimi në bazë të të dhënave të literaturës dhe puna praktike eksperimentale në teren.
2. Përpunimi i të dhënave, dhe
3. Shkrimi i tezës së masterit.

Qëllimi i kësaj teme të masterit ka qenë vlerësimi i faunës së arachnidave dhe aspektet taksonimike të llojeve të merimangoreve të Balkanin Përendimor. Me anë të këtij hulumtimi janë ofruar 15 gjetje të reja për faunë merimangoreve në Balkanin Përendimor, 6 opilione dhe 1 merimanga. Gjithashtu për herë të parë të pare është bërë barkodimi gjenetik i opilioneve.

Studimi është kryer në lokalitete të ndryshme në Balkanin Përendimor

Në kapitullin e Hyrjes kandidatja përshkruan në përgjithësi karakteristikat, grupeve shtazore të hulumtuara, rendësin e tyre dhe ekosisteme. Gjithashtu në këtë kapitull janë përfshirë edhe qëllimi i hulumtimit së bashku me pikat kyçe të këtij hulumtimi si dhe karakteristikat e grupeve shtazore të konstatuar gjatë këtij hulumtimi.

Në kapitullin Materiali dhe Metodat e punës janë paraqitur të dhënat për përzgjedhjen e objektit të hulumtimit, mënyrën e hulumtimit në teren dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave, dhe sekuencimi i mostrave. Në këtë kapitull shtjellohet në detaje metoda e marrjes së mostrave, konservimi i tyre si dhe determinimi.

Në kapitullin Rezultatet kandidati jep detajisht të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi. Të dhënat janë paraqitur në formë tabelare dhe në formë grafike duke e pasqyruar për secilin lokalitet përbërjen e faunës së Arachnidave

Në kapitullin e Diskutimit kandidati i diskuton të dhënat e fituara gjatë këtij hulumtimi me hulumtimet e kryera më parë.

Adaj, konsiderojmë se kandidati i ka plotësuar të gjitha kushtet për të propozuar KSHM të Departamentit të Biologjisë përkatësisht FSHMN që të aprovojë këtë raport dhe të lejojë kandidatit mbrojtjen e kësaj teme të masterit me titullin e lartshënuar.

Prishtinë, 10.09.2025

Komisioni:

1. Lindita Grigori - Kotori  
/ Prof. – mentor/
2. Agim Gashi  
/ Prof. – anëtar/
3. Asim Bilal  
/ Prof. – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.